



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

**PROGRAMI KOMBËTAR PËR OFRIMIN E
SHËRBIMEVE NË GJUHËN E SHENJAVE PËR
PERSONAT E SHURDHËR NË REPUBLIKËN E
KOSOVËS**

(2013-2016)



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

PROGRAMI KOMBËTAR PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË GJUHËN E SHENJAVE PËR PERSONAT E SHURDHËR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

(2013-2016)

Prishtinë, 2013

PERMBAJTJA

PRATHËNIE	4
FALËNDERIMET	5
AKRONIMET DHE SHKURTESAT	6
HYRJE	7
QËLLIMI	8
VIZIONI	8
MISIONI	8
SITUATA E PERSONAVE TË SHURDHËR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	9
Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe gjuha e shenjave	9
ZYRTARIZIMI I GJUHËS SË SHENJAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	10
PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT	12
OBJEKTIVAT E PROGRAMIT	13
Objektivi 1 Përgatitjet institucionale për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave ..	15
Objektivi 2 Qasja në arsim për Personat e Shurdhër	16
Objektivi: 3 Programi i trajnimeve në Gjuhën e Shenjave	18
Objektivi 4 Fushatë senzibilizuese për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave ..	19

PRATHËNIE

Republika e Kosovës që nga pavarësia e saj më 17 shkurt 2008, në rrugëtimin e saj të krijimit të institucioneve ka bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të krijuar një mjedis të ri ku në mënyrë të plotë garantohen dhe respektohen të drejtat e njeriut, dhe ku çdo pjesëtar i shoqërisë i ofrohen mundësi të barabarta në çdo aspekt të jetës.

Dhe tani mbi këtë parim këto të drejta janë të mbrojtura dhe të garantuara edhe nga akti më i lartë juridik i vendit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në të cilën të gjitha vlerat dhe parimet e barazisë janë parashikuar.

Për më tepër Republika e Kosovës në kushtetutën e vet ka përfshirë edhe instrumentet kryesore ndërkombëtare, të cilat i referohen mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Me këtë hap nënkuptohet edhe gatishmëria e mirë politike të institucioneve për të marrë përgjegjësinë për të përmbushur detyrimet ndërkombëtare të cilat sigurojnë të gjitha të drejtat themelore për të gjithë qytetarët e vendit.

Këtë e dëshmon edhe ky dokument qeveritar i cili në fokus ka personin e shurdhër dhe garantimin e një qasje të plotë të tij, në jetën e përditshme pa barriera.

FALËNDERIMET

Qeveria e Republikës së Kosovës në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është duke ofruar dhe zbatuar me përpikëri politikën e mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa dallim.

Me këtë rast ne falënderojmë të gjitha institucionet dhe organizatat për mbështetjen, ndihmesën dhe pjesëmarrjen e tyre, e veçanërisht komunitetin e të shurdhërve, Shoqatën Kosovare të Shurdhërve, Grupin Punues për Zyrtarizimin e Gjuhës së Shenjave, si dhe Shoqatën Finlandeze të të Shurdhërve nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës të cilët e kanë mbështetur dhe ndihmuar gjithë këtë procesi deri në finalizimin e Programit Kombëtar për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në Republikën e Kosovës (2013-2016) .

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

A

ASK/ZKM Agjensioni i Statistikave të Kosovës/Zyra e Kryeministrit

B

BK Buxheti i Kosovës

D

DNJ Të Drejtat e Njeriut

DKA Departamenti Komunal i Arsimit

DUDNJ Deklarata Universale për të Drejtave e Njeriut

K

KE Këshilli i Evropës

KDPAK Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

KE Komisioni Evropian

KNFSHIPAK Klasifikimi Ndërkombëtar mbi Funkcionimin, Shëndetin dhe Aftësitë e Kufizuara -

KB Kombet e Bashkuara

M

MASHT Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MAPL Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MPMS Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MSH Ministria e Shëndetësisë

MKRS Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

MTPT Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit

MEF Ministria e Ekonomisë dhe Financave

O

OJQ Organizata Joqeveritare

OPAK Organizata për Personat me Aftësi të Kufizuara

OBSH Organizata Botërore e Shëndetësisë

P

PKVPAK Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara

PAK Personat me Aftësi të Kufizuara

Sh

Shoqata Kosovare e të Shurdhërve

T

TIK Teknologjia e Informimit dhe e Komunikimit

U

UP Universiteti i Prishtinës

G

GP Grupi Punues

Z

ZKM Zyra e Kryeministrit

ZQM Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Jo Diskriminim

HYRJE

Komuniteti i të shurdhërve janë personat që i takojnë një grupi të veçante gjuhësor të cilët përdorin gjuhën e shenjave si gjuhë të parë. Gjuha e Shenjave¹ është në thelbin e jetesës së këtij komuniteti. Me gjuhën e shenjave personat e shurdhër kanë qasje në të gjitha sferat e jetesës ndërsa pa të personi i shurdhër mbetet i izoluar. Kështu, gëzimi i plotë i të drejtave të njeriut për personat e shurdhër është i bazuar në njohjen dhe respektimin e gjuhës së shenjave.

Andaj bazuar në këto fakte Republika e Kosovës në programin e saj ka vendosur si prioritet respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara me theks të veçante personave të shurdhër. Kjo e drejtë në vend është garantuar dhe siguruar me vendimin e Qeverisë 06/146 për zyrtarizimin e Gjuhës së Shenjave.

Ky vendim është i bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin antidiskriminues, Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara si dhe në dispozitat e Konventës së OKB-së mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Për më tepër ky Vendim e ka pozicionuar Kosovën në një ndër vendet e para në Ballkan që ka marrë këtë hap, dhe që përbën një shembull pozitiv për vendet e rajonit dhe më tej.

Dhe tani në vazhden e këtij procesi kemi implementimin e Programit Kombëtar për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave një dokument i cili paraqet një udhërrëfyes për ta siguruar këtë të drejtë gjuhësore për qytetarët e shurdhër.

¹ Gjuha e Shenjave është gjuhë e njohur zyrtarisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe e zhvilluar nga komuniteti i të shurdhërve në Republikën e Kosovës. Ajo quhet një gjuhë trupore për shkak se është e transmetuar nga trupi: duart, sytë, fytyra, vetullat, goja, koka dhe buzët ndërsa quhet vizuale sepse ajo është e perceptuar me anë të syve dhe funksionon pa zë.

QËLLIMI

Qëllimi i këtij programi është që të krijojë një shoqëri gjithëpërfshirëse e cila do të rrisë pjesëmarrjen e komunitetit të personave të shurdhër në të gjitha sferat e jetës në Republikën e Kosovës.

Pra si indikatorë i këtij dokumenti është mobilizimi i të gjithë institucioneve publike në vend për të hequr pengesat, të cilat në këtë rast janë komunikuese, që do të siguroj në të ardhmen pjesëmarrjen e plotë të personave të shurdhër.

Ky program do të fokusohet kryesisht në dy fusha që kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave si dhe mësimin në gjuhën e shenjave.

Ofrimi i shërbimeve do të arrihet përmes krijimit të një njësie për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave nga ku do të shërbehen të gjitha institucionet e vendit për çdo nevojë komunikuese që kanë qytetarët e saj.

Ndërsa mësimi në gjuhën e shenjave do të realizohet duke krijuar kushte në të cilat personat e shurdhër mund maksimalisht të realizojnë potencialet e tyre deri në gradat më të lartë të kualifikimit akademik.

Në gjithë këtë proces Organizata për Personat e Shurdhër ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë pjesë integrale në çdo vendim-marrje që influencon çdo person të shurdhër në vend.

Në fund mund të themi se ky program do të dëshmojë faktin se gjuha e shenjave është një gjuhë si të gjitha të tjerat e cila duhet respektuar dhe duhet mundësuar për personat e shurdhër si një e drejtë e patjetërsueshme.

Për më tepër gjuha e shenjave do të jetë baza e të mësuarit dhe e marrjes së njohurive, pra e zhvillimit të gjithanshëm dhe zhvillimit të vetë identitetit të Personave të Shurdhër në Republikën e Kosovës.

VIZIONI

Gjithëpërfshirjen dhe përmirësimin e mirëqenies e veçanërisht sigurimin e të drejtës për komunikim për personat e shurdhër si qytetarë me të drejta të barabarta në vend.

MISIONI

Të operacionalizoj Vendimin e Qeverisë për zyrtarizimin e Gjuhës së Shenjave në zgjidhje konkrete me veprime dhe afate për zbatim.

SITUATA E PERSONAVE TË SHURDHËR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Kur një grup i caktuar i njerëzve ndajnë qëllime të përbashkëta, dhe kryejnë përgjegjësi të caktuara në drejtim të njëri tjetrit ata formojnë një komunitet të caktuar. Gjuhën dhe kulturën e cakton apo e trashëgon komuniteti ndërsa për komunitetin e Personave të Shurdhër gjuha e shenjave është faktorë detyrues.

Komuniteti i Personave të Shurdhër nuk jetojnë në një zonë të caktuar gjeografike por janë të shtrirë gjithandej. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) vlerëson se janë rreth 59 milion njerëz (0,9% e popullsisë së përgjithshme) në botë me humbje të dëgjimit të klasifikuara si humbje të rënda (humbja e dëgjimit nga 61 dB ose më tepër) (OBSH 2005, Haualand dhe Colin 2009).

Ndërsa në bazë të regjistrimit të fundit në Republikën e Kosovës kemi gjithsej 9,935 persona të shurdhër dhe me dëmtime në dëgjim, ku prej tyre janë 4,683 femra dhe 5,252 meshkuj. Këto janë të dhënat e fundit mbi regjistrimin e popullatës për vitin 2013 në Republikën e Kosovës².

Ky numër i qytetarëve të shurdhër fatkeqësisht hasë në shumë pengesa në shumë aspekte të jetës e të cilat në fokus kanë komunikimin apo gjuhën e shenjave si gjuhë e parë.

Në këtë kontekst Zyra për Qeverisje të Mirë/ Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Shoqatën e Personave të Shurdhër në Kosovë dhe Shoqatën Finlandeze të të Shurdhërve kanë realizuar një hulumtim mbi Situatën e Personave të Shurdhër në Republikën e Kosovës. Të gjeturat në këtë hulumtim janë si vijon: p.sh sa i përket arsimimit nga 100 respondentët e Shurdhër 73 % kanë raportuar se kanë mbaruar shkollimin dhe prej tyre 63% kanë mbaruar shkollën e mesme, megjithatë shumica prej tyre janë analfabet (nuk din shkrim dhe lexim të gjuhës shqipe) apo sa i përket qasjes në shëndetësi 85 % nga 100 respondentëve thonë se qasja në shërbimet shëndetësore është e dobët gjendje jo e mire paraqitet edhe në fushat tjera si punësimi etj.

Kjo tregon nevojën për të vendose sa me shume prioritete në këto fusha e që sigurisht me Programin Kombëtarë për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave janë marr parasys.

² <http://esk.rks-gov.net>

ZYRTARIZIMI I GJUHËS SË SHENJAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Zyrtarizimi i gjuhëve të shenjave është një koncept shumë i gjerë dhe është implementuar në mënyra të ndryshme në shtete të ndryshme. Rruga të cilën kanë ndjekur shtetet në botë deri më tani për sigurimin (zyrtarizimin) e gjuhës së shenjave është si më poshtë:

- i. Në Kushtetutat e tyre
- ii. Në legjislacion, si në Ligjin e gjuhës së shenjave, Ligjin e edukimit, Ligji për anti-diskriminim apo përmes vendimeve parlamentare.
- iii. Nëpërmjet zyrtarizimit të gjuhës së shenjave nga ana e Qeverisë etj

Ndërsa në Republikën e Kosovës procesi i zyrtarizimit të gjuhës së shenjave ka filluar në bazë të një memorandum të mirëkuptimit në mes të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe Shoqatës së Personave të shurdhër.

Gjatë asaj kohe, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe Shoqata Kosovare e të Shurdhërve ishin partnerë të fortë duke e ngritur zërin e tyre për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe nevojave të personave të shurdhër, por edhe duke hartuar dhe nxjerr rekomandime për Qeverinë e Republikës së Kosovës për të marrë Vendimi për zyrtarizimin e gjuhës së shenjave.

Dhe kështu me vendimin³ e Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, datë 06.02.2007 u krijua, Grupi i Punues për zyrtarizimin e Gjuhës së Shenjave në Republikën e Kosovës. Grupi i Punës përbëhej nga institucionet si më poshtë:

- Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit, kryesues
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Shoqata e Personave të Shurdhër të Kosovës
- Klubi i Personave të Shurdhër në Prishtinë
- Klubi i Personave të Shurdhër në Pejë
- Shkolla e personave të shurdhër në Prizren
- Koalicioni i Organizata për Personat me Aftësi të Kufizuar
- Organizata për organizimin e trajnimeve dhe zhvillimit të gjuhës së shenjave

Qëllimi i krijimit të këtij Grupi Punues ishte të hartonte dhe dizajnonte dokumentin me të cilin Qeveria e Republikës së Kosovës do të zyrtarizojë gjuhën e shenjave.

³ Vendimi e Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit nr. 07/1048

Ky Grup ka finalizuar punën e tij me hulumtimin e realizuar mbi kushtet e jetesës së personave të shurdhër në vend. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte për të paraqitur gjendjen reale të personave të shurdhër në Republikën e Kosovës lidhur me Arsimin e personave të shurdhër si dhe mundësitë e bashkëpunimit dhe qasjes në shërbime dhe informacion për personat e shurdhër.

Dhe si rrjedhojë më 1 korrik 2010, Zyra e Kryeministrit / Zyra për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me të gjithë akterët relevant organizoi konferencën ku u publikua ky raport si dhe u prezantuan rekomandimet për Qeverinë e Republikës së Kosovës për të njohur gjuhën e shenjave si një domosdoshmëri dhe nevojë urgjente..

Rekomandime të cilat u morën për bazë dhe kështu më 29 shtator 2010 Qeveria e Republikë së Kosovës mori vendimin nr. 06/146 për zyrtarizimin e Gjuhës së Shenjave.

Dokumentet e mëposhtme ishin baza ligjore për zyrtarizimin e Gjuhës së Shenjave:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës,
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Ligji kundër Diskriminimit, nr. 2004 / 3, 19 shkurt 2004,
- Vendimi për themelimin e Grupit Punues për zyrtarizimin e gjuhës së shenjave
- Si dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2009-2011,

Kjo bëri që Republika e Kosovës të pozicionohet në një ndër vendet e para në Ballkan që kanë marrë këtë hap (vendim) dhe të shërbej si një shembull i mirë edhe për vendet e rajonit dhe më tej.

Më pas për zhvillimin e mëtejshëm të procesit, në rrjedhën e zbatimit të vendimit të Qeverisë për zyrtarizimin e gjuhës së shenjave ishte krijimi i një Grupi Punues për shqyrtimin e Politikës së Veprimit për Zyrtarizimin e Gjuhës së Shenjave, i cili është një mekanizëm për qasje institucionale për të hartuar një Program Kombëtar për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës.

Program ky i cili do të trajtojë çështje të rëndësishme për personat e shurdhër si në arsim, shëndetësi, mirëqenie sociale, drejtësisë, etj si dhe ka për vizion të krijojë një shoqëri gjithëpërfshirëse e cila do të rrisë pjesëmarrjen e këtij komuniteti në Republikën e Kosovës.

Në fund fare mund të themi se zyrtarizimi i gjuhës së shenjave nuk do ti zgjidh të gjitha problemet e personave të shurdhër, por njohja e saj ishte jetike për arritjen e një ndërhyrje bazë në ofrimin e mundësive të barabarta për personat që nuk dëgjojnë në të gjitha fushat e jetës në vendin tonë.

PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT

Institucionet e Republikës së Kosovës janë të angazhuara për një qasje të plotë për personat e shurdhër dhe për të maksimizuar potencialin e tyre që të marrin pjesë si qytetarë të barabartë në shoqërinë tonë.

Si rrjedhojë me Vendimin 06/146 Qeveria e Republikës së Kosovës bëri Zyrtarizimin e Gjuhës së Shenjave një hap ky shumë i rëndësishëm për këtë pjesë të shoqërisë tonë si dhe për vetë institucionet Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Në këtë mënyrë duke krijuar edhe kushtet e favorshme që të hartohen politika specifike për qasjen në gjuhën e shenjave për personat e Shurdhër.

Fillimisht me Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit u krijua Grupi Punues për shqyrtimin e një politike të veprimit për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave. Ky grup ishte nën koordinimin e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe përbëhej nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Sekretaria Koordinuese e Qeverisë si dhe Shoqata e Personave të Shurdhër.

Punën e këtij grupi apo hartimin e Programit Kombëtare për ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave e ndihmuan dhe një numër i ekspertëve nga këto institucione: Komisioni Evropian, OSBE, Qendra për hulumtime të shurdhësisë në Londër si dhe Shoqata Finlandeze e të Shurdhërve.

Përveç punës në grupi ky dokument nuk do të ishte aspak i kompletuar pa konsultimin dhe kontributin e vet komunitetit të personave të shurdhër. Kështu duke mbajtur punëtori në shumicën e komunave aty ku jetojnë dhe vepron ky komunitet gjë e cila ndihmoi që dokumenti të përfshinte nevojat reale të cilat u kumtuan nga vet komuniteti i personave të shurdhër.

Dhe sigurisht tani ky Program për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave 2013-2016 përmbledhë të gjitha objektivat të cilat përmbushin nevojat e Personave të Shurdhër për të krijuar një mjedis me qasje në gjuhën e shenjave në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT

PËRGATITJET INSTITUCIONALE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË GJUHËN E SHENJAVE

Zyrtarizimi i Gjuhës së Shenjave nuk do të zgjidhë menjëherë të gjitha problemet e Personave të Shurdhër, megjithatë njohja e saj nga ana e institucioneve nënkupton fillimin e një procesi të definimit dhe zhvillimit të saj.

Në objektiven e parë të Programit është analizuar gjatë sepse pikërisht kjo objektivi përshkon zgjidhjen për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Për më tepër duke hequr diskriminimin, përjashtimin dhe të gjitha pengesat që personat e shurdhër u përballën deri tani.

Në këtë kontekst do të krijohet Njësia për ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave, mekanizëm ky i cili do të kontrakttojë interpret profesional të gjuhës së shenjave për ofrimin e këtij shërbimi për qytetarët e shurdhër në tërë vendin.

Rregullorja e punës dhe funksionimit të njësisë do të përcaktohet nga një grup i caktuar apo i mandatar për rregullimin e këtij mekanizmi.

Sipas programit njësia do të filloj funksionimin e saj në vitin 2014 dhe fillimisht me 9,350 orë brenda vitit i cili përputhet me numrin e zyrtarë nga statistikat mbi numrin e personave të shurdhër në vend.

Gjithsesi për çdo vit kalendarik do të rishikohet fusha e veprimit të saj me qëllim të avancimit dhe sigurisht përmbushjes së nevojave komunikuese për Personat e Shurdhër si qytetarë me të drejta të barabarta në vend.

QASJA NË ARSIM PËR PERSONAT E SHURDHËR

Arsimimi i Personave të Shurdhër është një e drejtë e pakontestueshme në vend, megjithatë për një përmirësim të dukshëm në këtë dokument Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në bashkëpunim me aktorë tjerë përgjegjës merr përsipër veprime që i shërbejnë drejtpërdrejt arsimimit të personave të shurdhër.

Pra për të qenë në gjendje të komunikojnë efektivisht në gjuhën e shenjave, të lexojnë dhe shkruajnë gjuhën shqipe apo gjuhën të cilës i përkasin si komunitet, dhe kjo është sigurisht kurciale për aftësitë e personave të Shurdhër për të marrë pjesë plotësisht në shoqëri. KDPAK është një provë e rëndësishme për personat e Shurdhër kur diskutojnë lidhur me komunikimin dhe nivelin e edukimit të të Shurdhërve mbi bazën e të cilës janë vendosur edhe hapa konkret në kuadër të objektives mbi arsimimin në këtë dokument.

PROGRAMI I TRAJNIMEVE NË GJUHËN E SHENJAVE

Trajnimet në gjuhën e shenjave përbën objektiven e tretë dhe shumë të rëndësishme të këtij programi. Fillimisht trajnimet do të jenë të fokusuara tek trajnerët dhe interpretët e gjuhës së shenjave të cilët njëkohësisht do të jenë edhe stafi i certifikuar për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në kuadër të Njesisë për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave.

Ky trajnim është vlerësuar i domosdoshëm për të rritur kapacitetet në ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave duke pasur parasysh se deri tani numri i trajnerëve dhe interpretëve ka qenë shumë i limituar.

Për të siguruar një informim më të mirë qasje nga ana e personave të shurdhër në hapat vijues do të mbahen edhe trajnime bazike për institucionet që do të jenë përgjegjëse në ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave.

Duke përfunduar kështu edhe me trajnimet e familjarëve të personave të shurdhër duke qenë se nga hulumtimet e shumta vlerësohet se në terren vërtet ka një jo-komunikim në mes të familjarëve të ngushtë për shkak të pengesave komunikuese që ekzistojnë.

FUSHATË SENZIBILIZUESE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË GJUHËN E SHENJAVE

Zyra e Kryeministrit/ Zyra për Qeverisje të Mirë ka qenë pika koordinuese në gjithë këtë proces duke filluar nga hulumtimet e shumta për gjuhën e shenjave, inicimin për zyrtarizimin e gjuhës së shenjave si dhe hartimin e Programit për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave.

Në këtë kontekst ZKM/ZQM në bashkëpunim me të gjithë akterët relevant institucional dhe Shoqatën e Personave të Shurdhër do të realizojë fushatë me qëllim të promovimit dhe vetëdisimit të të gjithë qytetarëve mbi programin, botimin e fletushkave, reklamave bilbordeve dhe reklamat të ndryshme në TV dhe Radio si dhe përkthimin e Programit për personat e Shurdhër në gjuhën e shenjave për një qasje sa më adekuate.

Në fund fare Zyra e Kryeministrit/ Zyra për Qeverisje të Mirë do të jetë edhe trupi monitorues dhe raportues në zbatimin e të gjitha aktiviteteve të parapara në Programin Kombëtar për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave. Pra duke përgatitur raporte vjetore mbi të arriturat dhe sfidat në implementimin e këtij dokumenti.

Objektivi 1 Përgatitjet institucionale për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave					
Aktivitetet	Akterët implementues	Koha e raportimit	Indikatorët e suksesit	Afatet kohore	Burimet financiare
1.1. Themelimi i një Njësie për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave	ZKM/ZQM, SHKSH si dhe partnerët e tjerë relevant.	2014	Njësia e themeluar	2013	Nuk ka kosto buxhetore
1.1.1 Hartimi i rregullores së punës së Njesisë për ofrimin e shërbimeve të Gjuhës së Shenjave	ZKM/ZQM me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit do të krijoj Grupin Punues për hartimin e mandatit të njesisë	2014	Mandati dhe fushëveprimi i Njesisë është përcaktuar	2014	1,500.00 Euro
1.1.2 Funksionimi i Njesisë për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave.	ZKM/ZQM, SHKSH si dhe partnerët e tjerë relevant.	2015-2016	Fillimi i ofrimeve të shërbimeve në gjuhën e shenjave për qytetarët e Shurdhër në tërë Republikën e Kosovës.	2014-2016	99,350.00 euro

Objektivi 2**Qasja në arsim për Personat e Shurdhër**

Aktivitetet	Akterët implementues	Koha e raportimit	Indikatorët e suksesit	Afatet kohore	Burimet financiare
2.1 Licencimi dhe Akreditimi i programeve për trajnimin e Asistentëve të Klasave dhe Instruktorëve të Gjuhës së Shenjave	MASHT	2014	Programi i akredituar	2013	Nuk ka kosto buxhetore
2.1.1 Trajnimet për Asistent Klase dhe Instruktor të Gjuhës së Shenjave	MASHT dhe SHKSH	2014-2015	Numri i asistentëve të klasave dhe Instruktor të Gjuhës së Shenjave të certifikuar dhe të gatshëm që të punojnë	2014-2015	40,000 euro
2.2. Punësimi i Asistentëve të klasave dhe Instruktorëve të Gjuhës së shenjave në Qendrën Burimore dhe klasat e bashkangjitura.	MASHT	2016	Numri i asistentëve të klasave dhe Instruktor të Gjuhës së Shenjave të punësuar	2016	26,640 euro
2.3. Të sigurohen trajnime informuese lidhur me standardet më të larta të edukimit	MASHT dhe SHKSH	2014-2016	Numri i mësimeve që trajnohen	Në vazhdimësi	2000 euro

bilingual					
2.4 Të sigurojë që fëmijët e Shurdhër të moshës parashkollore tu ofrohet mësim dhe mjedis në gjuhën e shenjave	Komunat	2016	Numri i Asistentëve të punësuar në Institucionet parashkollore.	2016	20,000.00 euro
2.6 Përgatitja e materialeve të ndryshme mësimore të nevojshme (DVD) në gjuhën e shenjave, për nxënësit e shurdhër.	MASHT, Shkollat, SHKSH dhe Donatorë	2014-2016	Numri i materialeve të realizuara	Në vazhdimësi	1500 euro

Objektivi: 3**Programi i trajnimeve në Gjuhën e Shenjave**

Aktivitetet	Akterët implementues	Koha e raportimit	Indikatorët e suksesit	Afatet kohore	Burimet financiare
3.1. Trajnimi i trajnerëve të interpretove të Gjuhës së Shenjave	ZKM/ZQM Komunat SHKSH	2014-2016	Numri i trajnerëve të trajnuar	2014-2016	10,000.00 euro
3.1.1 Certifikimi i trajnerëve	SHKSH	2016	Numri i të certifikuarve për trajner në baza vjetore	2016	Nuk ka kosto buxhetore
3.1.2 Trajnimi i interpretove të Gjuhës së Shenjave	SHKSH Donatorë	2014-2016	Numri i të certifikuarve për interpret në baza vjetore	Në vazhdimësi	10,000.00 euro
3.2 Mbajtja e trajnimeve bazike mbi Gjuhën e Shenjave për institucionet relevante	ZKM/ZQM SHKSH	2014-2016	Numri i trajnimeve të mbajtura	Në vazhdimësi	5,000.00 euro
3.3 Mbajtja e trajnimeve për prindërit (kujdestarët) e fëmijëve të shurdhër	MASHT SHKSH Donatorë	2014-2015	Numri i prindërve (kujdestarëve) të trajnuar në Gjuhën e Shenjave	2014-2015	2000.00 euro

Objektivi 4 Fushatë senzibilizuese për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave

Aktivitetet	Akterët implementues	Koha e raportimit	Indikatorët e suksesit	Afatet kohore	Burimet financiare
4.1. Promovimi dhe vetëdisimi i të gjithë institucioneve dhe qytetarëve mbi Programin Kombëtar për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës	ZKM/ZQM dhe SHKSH	2014-2016	Numri i fushatave mbi promovimin dhe vetëdisimin lidhur me Programin	2014-2016	5,000.00 euro
4.2 Botimi i fletushkave, reklamave bilbord dhe reklamat të ndryshme në TV dhe Radio	ZKM/ZQM dhe SHKSH	2014-2016	Numri i fletushkave, reklamave në baza vjetore	2014-2016	3,000.00 euro
4.3. Përkthimi i Programit për personat e Shurdhër në gjuhën e shenjave	ZKM/ZQM dhe SHKSH	2014	Numri i kopjeve në DVD	2014	4,000.00 euro